



Shoqata Universale e Esperantos (UEA)
Fjalim në sesionin e dhjetë të Forumit për Pakicat
Pallati i Kombeve, OKB, Gjenevë, 30 nëntor- 1 dhjetor 2017

Arsimi përfshirës dhe pjesëmarrja e të rinjëve të pakicave në jetën publike

Zoti Kryetar, Zoti Raportues Special, përfaqësues të shtrënjtë të pakicave kombëtare apo etnike, fetare dhe gjuhësore, të shtrënjtë pjesëmarrës, tungjatjeta, *saluton!*

Unë quhem **Stefano Keller**, së bashku me kolegët e mij të pranishëm përfaqësoj **Shoqatën Universale të Esperantos (UEA)**, organizatën botërore të folësve të Esperantos, gjuhës ndërkombëtare. Ndyshe nga gjuhët e tjera, Esperanto nuk mund të ketë prirje imperialiste dhe nuk ka asnjë lidhje me inteersat ekonomike dhe politike. Ajo është gjuhë e atij që e zgjedh atë dhe krijon barazi gjuhësore në komunikimin ndërmjet popujve.

Shoqata Universale e Esperantos mbron të drejtat gjuhësore të gjithë pakicave dhe gjithë popujve vendas që prej më shumë se një shekulli.

Pothuaj të gjithë ata që e morën fjalën përmendën mungesën e mundësisë për të rinjtë e pakicave për të marrë arsim në gjuhën e vet prindore.

E drejta për arsim në gjuhën prindore është e drejtë themelore, sepse në gjuhën prindore ne fillojmë ta zbulojmë botën, të komunikojmë me të tjerët. Në gjuhën prindore kushdo nga ne është i aftë të mësojë më mirë, të ketë arsim duke arritur rezultate të mira.

Shoqata jonë i mbështet fort përpjekjet që synojnë këtë qëllim.

Do donim edhe të rikujtonim që mësimi i Esperantos është një bazë shumë e mirë për të nxënës krahas gjuhës prindore më lehtësisht gjuhët e tjera dhe mbështet kështu hapjen ndaj respektimit të popujve të tjerë.

Rekomandime

Të shtrënjtë pjesëmarrës, anëtarë të pakicave dhe vendimdhënës, ju rekomandojmë fort ta studioni dhe përdorni Udhëzuesin për realizimin e të drejtave gjuhësore të pakicave gjuhësore. *

*Falemnderit për vëmëndjen tuaj dhe një falenderim të veçantë për përkthyesit me zë dhe kolegët e tyre, që përkthejnë në gjuhën e xhesteve për punën e tyre shumë të rëndësishme!
Dankon !*

(albana traduko: [Bardhyl Selimi](#))